

MONITORIMI I PROCESIT TË PROKURIMIT NË KOMUNËN E MITROVICËS HARRIMI MILIONËSH



Kontrata: **Riparimi, rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në qytet dhe periferi**



Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur.**



Komuna e Mitrovicës

Ofertuan shtatë (7) operator ekonomik.
Kompania e kontraktuar: **Haxha COM.**



Çmimi: **1,667,260.00 €**

Disa prej çmimeve për punët e parapara në kontratë:

Gërryerja e sipërfaqes së asfaltit-betonit me makina përkatëse me trashësi t=3-5 cm, ngarkimi dhe bartja e materialit deri në deponinë e caktuar nga organi mbikëqyrës.

Sasia: 45,000 m²
Çmimi për njësi: 0.25
Çmimi total: 11,250 €

Pastrimi i sipërfaqeve të gërryera si dhe penetrimi me emulzion sipas normave dhe standardeve nga kjo lëmi.

Sasia: 55,000 m²
Çmimi për njësi: 1.80
Çmimi total: 99.000 €

Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e bituagregatit 0-16mm ,t= 8 cm.

Sasia: 98,600 m²
Çmimi për njësi: 8.49
Çmimi total: 837,144.00 €

Furnizimi dhe punimi i asfalt-betonit 0-11 mm me trashësi t=4cm.

Sasia: 66,500 m²
Çmimi për njësi: 4.90
Çmimi total: 325,850.00 €

PËRFUNDIME & REKOMANDIME:

Disa prej punëve të kontraktuara janë me cmime jo-normalisht të ulëta apo të larta.
Shembull: Çmimi për një metër katror zift i njohur si emulzion është vetëm 10 cent në disa projekte tjera.

Çmimet jo-normalisht të ulëta ofrojnë mundësi që të rritet çmimi i projektit, meqë do të realizohen vetëm punët me çmimin më të shtrenjtë.

Komuna duhet të sigurojë që nëpër tender të mos pranojë çmime jo-normalisht të ulëta apo të larta në asnjë pozicion.